



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**MBI PROGRAMIN E BURSIVE UNIVERSITARE NË GREQI  
VITI AKADEMIK 2020-2021**

Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës, Greqi, ofron gjashtë (6) bursa studimi universitare për studentë të shkëlqyer ndërkombëtarë në programin e studimit “*BA program in the Archaeology, History, and Literature of Ancient Greece*” për vitin akademik 2020-2021. Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës ofron një mundësi unike për studentë ndërkombëtarë që dëshirojnë të studiojnë kulturën e Greqisë antike përmes studimit të monumenteve arkeologjike dhe vendeve të tilla si Akropoli i Athinës, Delfi dhe Olimpia. Ky program 4-vjeçar BA mësohet në gjuhën angleze dhe i kushtohet studimit të antikitetit grek. Gjithashtu, studentët ndërkombëtarë që do të ndjekin studimet universitare në programin e studimit BA mund të zgjedhin të mësojnë edhe greqishten moderne nga mësues të specializuar duke e lidhur Greqinë e sotme përmes studimit të së kaluarës.

Përveç maturantëve të shkollave të mesme të cilët do të regjistrohen në këtë program të plotë katërvjeçar BA, mund të aplikojnë për bursa studimi edhe studentët e universiteteve në kuadër të shkëmbimeve akademike në periudha nga një deri në dy vite akademike bazuar në marrëveshjet dypalëshe ndërmjet universiteteve respektive.

Bursat për programin universitar 4-vjeçar “*BA program in the Archaeology, History, and Literature of Ancient Greece*” kanë një vlerë prej 10,000 eurosh secila. Afati i fundit për aplikim është data **30 qershor 2020**. Rezultatet do të shpallen nga Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës deri më **10 korrik 2020**.

Për detaje të tjera, për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit për bursat e ofruara nga Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës, kandidatët mund t’i referohen materialit bashkëlidhur dhe adresave të mëposhtme të internetit:

<https://baag.uoa.gr/admission/>;

<https://baag.uoa.gr/application/>

<https://baag.uoa.gr/scholarships/>

[https://baag.uoa.gr/fileadmin/depts/baag.uoa.gr/uploads/News/Covid19\\_insights.pdf](https://baag.uoa.gr/fileadmin/depts/baag.uoa.gr/uploads/News/Covid19_insights.pdf)

email: [info@baag.uoa.gr](mailto:info@baag.uoa.gr);

Tel: +30 210 727 7683, +30 697494143

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**